

GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor:
Zv/kryeredaktore -
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Shënim hyrës

«Gazeta Shqiptare», e themeluar nga një italian synoi vendosjen e standarteve profesionale në shtypin shqiptar dhe deri diku ia arriti. Profesionalizmi dhe investimi italian dhe për interesa përveç shtypit, bëri që ajo t’i rezistojë kohës. Në këtë gazetë unë botova 10 shkrime analitike, 28 faqe, në shtrirje kohore nga 1999 deri me 2015.

Nuk bëhet fjalë për bashkëpunim por për botime shkrimesh me rendësi të veçantë, që mund të bënin jehonë më mirë.

Interesant dhe i kuptueshëm është fakti se në këtë gazetë nuk kam botuar shkrime për marrëdhëniet shqiptaro-greke e as gjendjen në minoritetin etnik grek. Mëgjithatë duhet venë re botimet në këtë gazetë fillojnë me një shkrim për Kosovën, që mban datën 09.04.1999. Në momentin pra që që bombardimet e NATO-s ishin në kulmin e tyre dhe në mjedisin shqiptar ideja e fitores mbi Serbinë, e bashkimit të trojeve shqiptare, e korrigjimit të historisë etj, ishte absolute dhe në ekstazë, unë fola se zgjidhja për Kosovën është ndarja e saj.

Po ashtu janë botuar dhe analiza të tjera që kishin të bënin me atë fazë të rendësishme tranzicioni.

Εισήγηση.

Η «Gazeta Shqiptare», ιδρύθηκε από έναν Ιταλό με την προσδοκία της καλλιέργειας του δημοσιογραφικού επαγγελματισμού στα αλβανικά ΜΜΕ και μέχρι ως ένα σημείο πέτυχε. Ο επαγγελματισμός και η ιταλική επένδυση η οποία προσέβλεπε και πέρα από τα του τύπου, συνέβαλαν στην αντοχή της εφημερίδας. Στην συγκεκριμένη εφημερίδα δημοσίευσα 10 άρθρα, 28 σελίδες και σε χρονική διάρκεια από το 1999 μέχρι το 2015. Δεν πρόκειται για συνεργασία αλλά για δημοσίευση άρθρων γνώμης ιδιαίτερης σημασίας, που απαιτούσαν μεγαλύτερη απήχηση.

Με ενδιαφέρον αλλά κατανοητό, είναι το γεγονός ότι στην εφημερίδα αυτή δεν δημοσίευσα άρθρα για τις διμερείς σχέσεις και για την κατάσταση στον Ελληνισμό της Αλβανίας. Πρέπει όμως να προσεχθεί ότι τα δημοσιεύματα στην εφημερίδα αυτή αρχίζουν με ένα άρθρο που φέρει ημερομηνία 09.04.1999. Τότε λοιπόν, όταν ταν σε εξέλιξη οι βομβαρδισμοί του ΝΑΤΟ και στο αλβανικό περιβάλλον μεσουρανούσε ο ενθουσιασμός για την νίκη κατά της Σερβίας, για την ένωση των αλβανικών εδαφών, για την διόρθωση των ιστορικών λαθών, εγώ έγραφα ότι η λύση για το Κόσοβο είναι η διχοτόμηση.

Έχουν δημοσιευτεί επίσης, και άλλες πολιτικές αναλύσεις που αφορούσαν την κρίσιμη εκείνη μεταβατική περίοδο.

PERMBAJTJA

1. **Me logjiken jasht emocioneve**
09.04.1999 faq. 3.
2. **Doreza e hedhur e Nanos**
05. 12.2001 faq. 6.
3. **Realiteti i zymtë e bën më të pashpresë të ardhmën**
Janar 2002 faq. 9.
4. **Partia Socialiste në rrathë krizash**
07.02.2002/09.02.2002 faq. 12.
5. **Rrerthi vicioz i krizës në vend**
15.03.2002 faq. 14.
6. **Raundi i parë i zgjedhjeve lokale dhe realiteti i vështirë politik.**
14.10.2003 faq. 16.
7. **Zgjedhjet lokale, pozita dhe perspektiva e liderit të ri të opozitës**
07.01.2007 faq. 19.
8. **Skandale në oborrin e PBDNj-së kompromentojnë keq misionin e politik të lidershipit të tij.**
02.02.2009/04.02.2009 faq. 22.
9. **Zgjedhjet e 28 Qershorit pasqyrë e realitetit politiko-shoqëror të vendit**
21.07.2009 faq. 24
10. **Polifonia, si produkt multikulturor shekullor është e Epirit**
Intervistë tek Gazeta shqiptare për deklaratën time në lidhje me polifoninë.
30.08.2015 faq. 28.
11. **Fund** faq. 29

Nga Panajot Barka

Me logjiken jasht emocioneve

09.04.1999

Konflikti dhe lufta ne Kosove, shenoi ne kete fund shekulli dhe ne sy te botës së civilizuar një tragjedi njërezore midis popullsise shqiptare te Kosovës të përmasave të tilla,që do ta kishin zili dhe ideusit e zbatuesit e kryqëzatave me te renda mesjetare. Ky është konstatimi i parë dhe më i dhimbshëm për për çdo qenje njërezore dhe shoqërinë bashkëkohore në përgjithësi.

Konstatimi i dytë lidhet me faktin se me këtë konflikt u angazhuan vendet dhe organizmat me peshë absolute në çdo zhvillim ndërkombëtar.

Konstatimi i tretë lidhet me atë se edhe kjo luftë ka prapaskenen dhe paraskenën e saj. Ana e jashtme, pra paraskena, është ajo që shohim të tërë me dhimbje, kuptohet dhe po ashtu me pafuqi për të penguar këtë rjedhë tragjike. Të pafuqishme jane madje dhe qeveri e vende që disponojne fuqi politike e ekonomike të konsiderueshme. Në këtë kuadër, atë që mund të bëjmë janë shpesh hipotezat e shumta për të zbuluar atë ç'po ndodh dhe për të përcaktuar sidomos perspektivën. Analistë politikë, politikanë, ushtarakë e njerëz te thjeshtë bejnë bilancin e tyre që shkon nga ndërhyrja e forcave ushtarake të NATO-s, tek pavarësia e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë, deri në copëtimin e saj, ndryshimin e kufijve dhe krijimin e një harte të re Ballkanike, tek destabilizimi i vendeve të tjera ballkanike, krijimin e një uniteti islamik ne zemer të Evropës me qendër Shqipërinë etj, ku gjithçka mbëtet sa hipotezë aq dhe e vërtetë.

Konstatimi i katert lidhet me faktin se dëshira për korrigjimin e gabimeve të historisë që është mëse e drejtë për të gjithë, kultivon një arsye subjektive, emocionale që çon në gjykimin e situatave dhe të zhvillimeve mbi bazen e kësaj arsyeje. Kjo lidhet edhe me faktin se kesaj hërë faktoret determinant per zhvillimet ne botë, NATO-ja, SHBA-ja, etj, jane me anën e shqiptareve, fakt që bashke me arsyen emocionale që thame me lartë, i bën shumë njerëz në Shqipëri, deri dhe politikën zyrtare, të mendojnë se historia është në prag të korrigjimit dhe vetëm në favor të Shqipërisë. Këtu harrohet parimi i lashtë se lufta e Trojës nuk u bë për shkak të Helenës së bukur dhe as Lufta e Pare Boterore u shkaktua për shkak të vrasjës se një princi. Të gjitha luftrat, pra u benë dhe po bëhen thjesht për interesa ekonomike, politike, fetare, etnike, etj dhe mbartin etiketën e vendosjes së drejtësisë.

Le të mos harrojmë, në këtë kuadër se ishte po ky Klinton që për arritjen e Dejtonit e konsideroi Miloshevicin «faktor stabiliteti dhe paqeje» ne Ballkan. Po ashtu deri me sot Shtepia e Bardhë nuk e akuzoi Miloshevicin si kriminel lufte. Nga ana tjetër është e vertetë se me kembënguljen Anglo-Amerikane Millosevici bombardohet për një kohë aq të gjatë sa i dha mundësinë Millosevicit që ta spastroje etnikisht Kosovën. Madje ndonjëherë bombat e NATO-s ndihmojnë shkatërrimin ekonomik të Kosovës. Logjika të thotë që nuk janë thjesht te drejtat e shqiptareve ato që i shtyjnë Amerikanët, Anglezet dhe vendet e tjera të NATO-s apo dhe te Bashkimit Evropiane që te harxhojne disa dhjetra miliard dollarë për luftën dhe po aq për të mbyllur plagët e saj (!!)

UDHEKRYQI I VESHTIRE I ZGJIDHJES

Gjendja e krijuar tanimë në Kosovë aq sa lidhet me katastrofen njerezore dhe ekonomike të saj, aq lidhet dhe më të ardhmen e Kosovës. Gjendja e tanishme pra e ka kapërcyer stadin e Rambujes. E kemi fjalën për faktin se tanime nuk mund të behet fjalë për asnjë lloj bashkëjetese midis kosovareve dhe serbeve. Kjo e vertetë shvlereson njëkohesisht çdo thirrje të komunitetit nderkombetar për lëjimin e kthimit të shqiptareve ne vatrat e tyre, pa zgjidhur fillimisht statusin e Kosovës.

Kuptohet që si për shqiptarët por edhe për komunitetin ndërkombëtar është i papranueshëm fakti i spastrimit etnik të popullsisë shqiptare nga Kosova. Shqiptarët nuk do të pranojnë as copetimin e Kosovës. Po ashtu sërëbet nuk do të pranojnë pavarasine apo shkeputjen e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar është negativ për këtë alternativë. I papranueshem mbëtet për sërëbet dhe varianti i nderhyrjes së NATO-s ne Kosovë. Madje një variant i tillë duket se do të çojë në ndryshim qëndrimi nga ana e Ruisë që do të thotë zhvillime të tjera. Pra, logjika e ftohtë dhe e çliruar nga emocionet kërkon një përgjigje për këtë udhekryq të çeshtjes se Kosovës që tanimë përbën një çeshje ballkanike madje dhe evropiane e boterore.

Eshtë e kuptueshme gjithashtu që një situatë e tillë mbart rreziqe për destabilizim të situatës në ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë, në Shqipëri, në Greqi, apo edhe me gjerë, një destabilizim që mund të jetë sa politik aq edhe shtetëror e fetar. Ky rrezik është më i vogël për aq kohë sa situata në përgjithësi do të jetë nën kontroll (dhe në planët e atyre që ushtrojnë këtë kontroll, nuk parashikohet diçka e tille), dhe ky rrezik është më i madh që nga momenti që situata dhe logjika e luftës dalin jashtë kontrollit. Atëherë epiqendra sizmike e Kosovës do të këtë goditjet metasizmike në të gjithë rajonin e Ballkanit me një hartë shtetesh multi-etnike.

METASIZMIKA DESTABILIZUESE E KONFLIKTIT DHE MINORITETI GREK

Pikërisht kundër kësaj logjike kërkon të pozicionohet edhe minoriteti etnik grek në Shqipëri. Vet fakti që në dy mesazhet e para të Klintonit, me fillimin e operacioneve të NATO-s kundër Jugosllavisë (26-28 mars) ky minoritet përbente pjesë të këtyre mesazheve, (ku herën e parë e lidhte këtë minoritet me mundësinë e përfshirjes në konflikt të Greqisë me Turqinë dhe herën e dytë në lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet në Kosovë), e bën këtë minoritet pjesë të zgjerimit të mundshëm të krizës.

Fakt është se midis anëtarëve të minoritetit grek dhe shqiptarëve egzistojne marrëdhënie të ekuilibruara, të mira dhe të qëndrueshme nga një bashkëjetesë tepër e gjatë midis tyre të percaktuara nga një substrat historik kulturor dhe fetar të përbashkët, ose të përafert. Ishin pikërisht këto marrëdhënie që e ndihmuan minoritetin të kapërxente momentet e nxehta krize, sidomos gjatë dhetevjecarit të fundit.

Lë të kujtojmë se më 1989-90 u bënë përpjekje të jashtëzakonshme për të destabilizuar regjimin komunist duke përdorur si shkak te drejtat e ketij minoriteti, apo duke krijuar premisa për përplasje midis shqiptarëve dhe minoritarëve. Më 1993-94 dy herë radhazi u bënë të njehta përpjekje për të provokuar përplasje fetare apo u përdorë minoriteti etnik grek për të prishur marrëdhënjet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Minoriteti, të gjitha këto provokime i kapërceu se ato nuk gjetën mbështetjen e faktorit bashkëjetues shqiptar

Po ashtu mese njeherë kriza 1997 iu faturua, nga qarqe të caktuara, Greqisë nëpërmjet Minoritetit Etnik Grek, i cili nga ana e vet zyrtarisht u distancua nga pjesëmarrja ne keto ngjarje.

Pikërisht një qëndrim te përafert mban tani Minoriteti Etnik Grek edhe ndaj problemit te refugjateve Kosovarë. Ky minoritet iu gjend kosovarëve ne krah që në momentin e parë, pasi ishin dhe janë biznesmenet minoritarë të parët dhe unanimisht që dhanë ndihma në ushqime dhe në të holla për kosovarët. Tani çdo familje minoritaresh grekë po e bën të njejtën gjë. Po ashtu ishte udheheqja e OMONIAS që i kerkoj zyrtarisht qeverisë greke akordimin e ndihmave për refugjatët kosovarë, gjë që po behet realitet

Qendrimi i OMONIA-s dhe i autoritetëve të minoritetit grek për të mos marrë refugjatë Kosovare në krahinat ku banon ky minoritet duhet sqaruar se, se pari është në të njëjtë linjë me qëndrimet e qeverisë tonë dhe asaj greke.

Po ashtu ky qendrim nuk lidhet aq me prishjen e mundshme të ekulibreve demografike e fetare në Jug, gjë që për të cili s'ka pse te mbajë përgjegjesi minoriteti, aq sa me mundesinë e provokimëve të ndryshme dhe përpjekjeve për t'i prishur ekulibret tradicionale në popullsinë e Jugut, duke përdorur për këtë, pse jo refugjatë kosovarë si faktor me sensibilitet më të madh. Përvoja nga qëndrimet e Shkupit ndaj refugjateve, flet qart për një sensibilitet të tillë. Po ashtu vet ministri Koci duke folur, gjate vizitës së tij ne Gjirokastër ditet e fundit, për qarqe që duan destabilizimin e vendit, la të kuptohet po të njëjtën gjë. Argumenti i të qenit shtet shqiptar edhe minoriteti, që askush nuk e mohon, nuk e rezon argumentin e krijimit të situatave destabilizuese. Problemi që shtrohet është:- në kushtet e inegzistencës së shtetit dhe rendit kush mund të parashikojë ç'mund të ndodhë, n.q.s në një qendër të banuar nga minoritarë vendosen Kosovare refugjatë dhe vriten, larg qoftë, në menyre provokative një apo disa anëtarë te minoritetit, apo, po larg qoftë, një apo disa refugjatë kosovarë, apo dhe qytetarë shqiptar. Apo ndodh ndonjë provokim tjetër? Incidenti i Peshkopisë më 1994, është ende i fresket dhe flet shume po të kemi parasysh se rekrutet kufitarë u derguan në kufi, duke shkelur ligjin dhe u lanë pa armë e ndërlihdje. Keto provokime janë më të mundshme kur qarqet nacionaliste duke shfrytezuar miqesine greko-serbe kane rritur se tepermi frymen antigreke sipas parimit miku i armikut tim, është armiku im dhe kur në momente të tilla ngrihen tonet për mohimin e historisë në lidhje me minoritetin. Minoriteti ka një histori të njohur dhe jeton një realitet po të njohur në kuadrin e shoqërisë Shqiptare dhe do të dije shumë mirë t'i përgjigjet çdo lloj sfide pa cenuar kend. Po ashtu provokime të tilla mund të jenë produkt edhe i qarqeve me kahje tjetër.

Pra e mira është që para se të bëjmë propagandë emocionale apo të ndikuar nga qendrimet keqdashese, lë t'i lemë vend arsyes së ftohtë dhe parandaluese të fatkeqësive të tjera. Kjo përbën një tolerancë që fare mirë e kuptojnë, brenda vuajtjeve të tyre refugjatët kosovarë, por duhet ta kuptojnë dhe ata që kërkojnë të sjellin refugjatë por që pastaj duan t'i ushqejnë të tjerë

P BARKA 09.04.99 Gaz Shqiptare

Nga P. Barka
Doreza e hedhur e Nanos
05. 12.2001

Fatos Nano hodhi serish në arenën e politikës shqiptare dorezën. Ajo, edhe pse kësaj here është mbuluar me kadifen e butë rozë, prap se prap bëri shumë zhurmë. Historia rozë e tij doli përballë krizës morale të partisë që drejton. Kjo nxiti mendimin se Nanua përdori moralin e shprishur, sipas tij, të PS-së, për të shpëtuar vetën nga një kosto të rendë politike që mund të shkaktonte në mjedisin tonë konservator mentaliteti i moralit të historisë rozë të Nanos. Mirëpo Nanua e hapi edhe më lojën me autopropozimin i tij për të qenë presidenti i ardhshëm i vendit dhe kjo çorjentoj rjedhën e politikës që impononin të huajt, jo vetëm të PS-së, por dhe të vendit.

I gjithë ky silogjizëm bëri që doreza e hedhur e Nanos të mbëtej atje, mbi tapetin e arenës e kudruar nga të gjithë, por nga pika të ndryshme veshtrimi. Disa e shikojnë si dorezën e të mundurit, disa si hakmarrje për plengprishësit, disa si dorezën e vëllait të madh që nuk e degjon më njëri, disa si mënyrën më të mirë për t u imponuar partisë për t u çvendosur në postin Presidentit të Republikës si terheqjen më prestigjioze dhe njëkohësisht më e butë nga politika aktive. Ca të tjerë e shikojnë si aktin e fundit të ciklit të mbyllur të një politikani eksponent në politikën e dhjetëvjeçarit të fundit në Shqipëri Ka dhe nga ata që mendojnë se Fatos Nano e lëshoi dorëzën për të shpëtuar Partinë Socialiste nga katastrofa dhe për të penguar ardhjen e Berishës në Qeveri.

Fakt është që Nanua ia arriti qëllimi të parë. Çudia “Xhoana” nuk bëri përjashtim nga rregulli. Nuk zgjati më shumë se tri ditë. (Ndërsa historia “Rexhina” do të përbejë më sa duket aktin me dramatik të skenarit me tradhëti politike ndaj Nanos të kohës së Bençës që ai sigurisht do ta luaj në betejën politike branda llojit që sapo nisi).

Realiteti i krizës në PS dhe formula e luftës politike e Nanos

Formula e luftës politike e Fatos Nanos duket se u shpalo në Gjirokastër. Ai tha qart aty se kriza morale çon në krizë instituocionale dhe kriza institucionale në zgjedhje të parakohshme.

Nuk rendësi nëse e pranojnë apo nuk e pranojnë socialistët krizën. Përplasja e kujdoqoftë me institucionin e kryetarit të partisë reflekton krizë. Kjo krizë pavarësisht nga forma e shfaqjes ka disa shkaqe. Së pari është produkt i përplasjeve të vjetër në P.S midis grupit të nënkryetarëve dhe Nanos së burgosur që morën formën e plotë në mocionin e Nanos për kongresin dyfazor të PS-së në vitin 1996. Në rrugën e gjatë të përplasjeve Meta me taktikën sulmuese duke fshehur ambicjet e karrierës i shkepuste Nanos terren nëpërmjet postëve deri në atë të Kryministrit. Shkaku i dytë duhet kërkuar në defektet e qeverisjes. Korupsioni, trafiqet, kriza energjitike, nepotizmi klanor e krahinor përbejnë një plagë shumë të mëdha për qeverinë. Se treti, shakqet duhen kërkuar tek dualizmi konfliktual në kreun e partisë në pushtet me një kryetar dhe një kryeministër. Kjo duhet parë jo si deshtim i formulës së njohur se sa si rishfaqja i përplasjeve të vjetër. Kryministri ambicioz nga njëra anë ndjen vazhdimisht revanshin e kryetarit kongret të partisë dhe nga ana tjetër mendon se duke pasur në dorë edhe partinë mund të qeverisë pa problemet e tanishme të brendshme

Nanua e kuptonte se Meta po shkonte shumë larg në ambicjet e tij dhe bëhej gati për të filluar betejën kundër tij që parazgjedhjeve. Fjalimi para elektoral në Lezhë ishte sinjali i parë ku Nanua veç se pati si mbeshetje akuzat e Perendimit për qeverinë Meta, kërkoi në krah të betejës së tij edhe shtypin. Por hoqi dorë se mund të bëhej shkak që PS-ja të humbiste zgjedhjet. Kjo përplasje u bë e pashmangshme pas humjeve të njëpasnjëshme të Nanos brenda forumëve të partisë, ku ai mbeti në minorancë, madje edhe pa bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë që shumë herë e nxorrën nga balta.

Realiteti i luftës politike të Nanos

Po cili është qëllimi i Nanos? Kërkon vertet shpëtimin e partisë nga kriza morale dhe të qeverisë nga deshtimi i afërm, apo kërkon që duke iu imponuar strukturave të partisë dhe instancionëve shtetërore në emër të asaj që vertet shkon keq në qeveri e parti, të reshqas në postin e presidentit, ose të paktën të rimarrë në mënyrë të përforcuar drejtimin e partisë? Mëesa duket synimi kryesor është presidenca

Mjetët që zgjodhi Nanua në këtë betejë janë të thjeshta. Së pari. Ai rikon edhe njëherë mbështetjen e bazës. Për këtë ai rrembeu flamurin e rrezikut të partisë dhe humbjes se ngahërshme të pushtetit nga qeverisja e keqe. Në parim ai ka të drejtë dhe të gjithë e dinë se vetëm nevoja për një Shqipëri të stabilizuar politikisht në një rajon të trazuar, lufta kundër terrorizmit dhe faktori Berishë, përbëjnë faktorët e përkrahjes Perendimore të Metës. Por a ka të drejtën morale Fatos Nanua në këto pretendime. A mund të arrij kryetari i një partie të shaj në publik qeverinë e partisë së tij? Kjo do të thotë se kriza e brendshme në PS dhe në qeverinë e saj kanë shkuar shumë larg dhe PS-ja humbet automatikisht të drejtën e qeverisjes. Nga ana tjetër vet Fatos Nanua nuk ka të drejtën morale të kërkoj tani llogari. Dhembët e mosmirnjohjes i tregoi ai fillimisht tek bashkpunëtorët e tij. Rrathet e korupsionit dhe trafikëve u ntrashën nën hundët e tij gjersa zunë shtetin prej fyti. Arrivizmin në parti e kultivoi po ai ashtu siç ishte ai që lejoi të thellohej mentaliteti i kohës së Berishës se pushteti politik në Shqipëri, është biznesi më fitimprurës në botë.

Mëgjthatë, po të kemi parasysh kompromiset e deritanishme në PS, të imponuara nga nevoja e mbajtjes së pushtetit, “lufta parimore “ e Nanos, mund të çojë në rizgjedhjen e tij në krye të PS-së. Në rast se Nanua e ka ndarë mendjen për postin e Presidentit, ai në një fazë të dytë mund ta banalizojë edhe më luftën kundër Metës duke nxjerrë nga arshivat në publik ose “në vende të caktuara” gjithçka zotëron nga “bëmat” e kundërshtarëve të tij. Dhe kuptohet se ka materiale të bollshme për këto gjera.

Së dyti. Ai, duket se në shërbim të ambicijës për president, kërkon të shrytëzojë institucionin e kryetarit dhe minorancën e kontrolluar prej tij për efekte bllokuese në parti, qeveri, parlament, me kërcenimin për zgjedhje të parakohshme. Kjo kuptohet mund të japi efekte të mënjëhershme por shumë të rënda për PS-në dhe qeverisjen e saj. Brenda logjikës së politikës shqiptare pra, kjo do të thotë se midis dy të keqijave PS mund të pranojë të keqën më të vogël. D.m.th PS-ja më një kompromis të brendshëm të pranojë që 84 votat e kontrolluara prej saj në parlament të shkojnë pro Nanos kur të vijë koha e zgjedhjes së presidentit. Një lëvizje e tillë do të ishte një veprim elegant i P.S-së për të larë duart me Nanon

Mirëpo, Nanua i trembur nga pabesitë që ai edukoi në parti, kërkon garanci që tani për këtë. Mirëpo PS-ja nuk mund të japi garanci të tilla kur dihet që, sipas orientimeve të Perendimit, që për ne janë si orientimet e kahershme të Partisë së Enverit, zgjedhja e presidentit nga opozita verën e vitit 2002, përbën zgjidhjen e mundshme të krizës tjetër, asaj të bojkotimit të parlamentit nga opozita.

Eshtë kjo arsyeja që PS-ja krizën e vet qoftë edhe si përplasje me Nanon, kërkon ta paraqes si krizë personale të kryetarit Kjo thekson mundësinë e humbjes së kontrollit nga ana e Nanos dhe çuarjen e tij në veprime nga pozitat e humbësit të madh. Një taktikë e tillë mund të çoj dhe PS-në në një pozitë humbëse të pushtetit dhe të unitetit të mbajtur, sidomos vitet e fundit, nga egzistenca e këtij pushteti.

Nga ana tjetër kalimi i Nanos në postin e presidencës zgjidh problemin e Nanos, ndërsa problemet e PS-së vetëm përkohësisht. Madje do të humbasë një pikë referimi për këtë unitet. Ndërsa në planin e përgjithshëm rishtrohet për zgjidhje spektri i politikës shqiptare.

Një zhvillim i tillë kuptohet që do të ndryshojë madje dhe i ndryshon rjedhat edhe në PD-në e Berishës. Presioni i jashtëm dhe presioni i brendshëm në këtë parti të imponuar nga humbjet e njëpasnjëshme zgjedhore, mund të çojnë në kongresin e dhjetorit në heqjen e Berishës nga kreu i PD-së , në ristrukturimin e një të djathtë të bashkuar dhe kalimin e pushtetit tek ajo. Mirëpo zhvillimet e mundshme të përshpejtuara në PS, deri në mundësinë e provokimit të zgjedhjeve të parakohshme, mund të radikalizojë serishmi qendrimet në PD me mendimin se kësaj here edhe me Berishën mund të fitohen zgjedhjet. Një zhvillim i tillë do të sjell si pasojë domosdoshmerinë e balancimit të Berishës serishmi nga Nano. Kështu krijohen premisa që politika shqiptare mund të riblokohet serishmi në këto dy emra **FUND PANAJOT BARKA**

Nga Panajot Barka

Realiteti i zymtë e bën më të pashpresë të ardhmën

Janar 2002

Përprojekja e Metës për të rikonfirmuar autoritetin e plotë kryeministrot në sfondin e zbutur të tonëve të Nanos, në shfaqjen e parë të tyre të pasfestave, nuk ndryshojnë aspak rrjedhën e zhvillimëve politike të muajve të fundit në vend me amplitudë të vetme krizën e mazhorancës në pushtet si pjesë e dukshme e gjithë krizës së sistemit pluralist shqiptar. Elementi më i ri i këtyre zhvillimëve është përprojekja e Berishës për t'i kondicionuar ato në favor të tij.

Mëgjithatë zhvillimet e fundit politike në vend, me paralizimin e qeverisë, bllokimin e parlamentit dhe të institucionit të Presidentit treguan gjithashtu se si në PS, ashtu si dhe në politikën shqiptare, instrumentat morale në ushtrimin e politikës dhe të veprimtarisë civile në përgjithësi janë inegzistente, ashtu siç janë inegzistente edhe mjetet institucionale që do të impononin veprimin e tyre.

Pesha dhe rreziku i krizës ekonomike

Egziston një krizë dhe pasojat e saj rendojnë deri në asfiksi tek zgjedhësit. Mungesa e dritave dhe e ujit, janë shumë pak para faktit që rreth 40 përqind e popullsisë jetojnë në kufij e varfërisë absolute. Janë shumë pak para detyrimit sklavopronar të shitjes së femijës, gruas vajzës për të siguruar kafshatën e gojës, apo lulëzimit të kimit në familje dhe të vetvrasjes si shprehje e shkatërrimit të bazës së shoqërisë,-familjës

Po ashtu lejimi i kanaleve të shumta të trafiqëve dhe të pastrimit të parave krijuan nga njëra anë realitetin fals të stabilitetit financiar. Nga ana tjetër, ashtu si piramidat deri para 97-ës, u kalojnë në duart e njërezve të këtyre kanalëve të gjitha pasuritë shtetërore: - trojet, bregdeti, vendet turistike, njësitë ekonomike etj. Tregues i përmasave alarmante të këtij fenomeni janë çmimet deri në 7 milion lekë për metër katror sipërfaqe e ndërtuar në kryeqytet. Kjo makuteri tregon gjithashtu se sa të përjashtuar janë njërezit e thjeshtë nga rishperndarja e vlerave materiale të krijuara për dekada vitesh pune të pashpërblyer. Lidhjet e drejtpërdrejta të politikanëve në pushtet me këta njërez tregon se pas administrimit të përbashkët të vlerave ekonomike, realizohet ndarrja me ta i pushtetit politik dhe kalimi i tij dhe i shtetit në duart dhe në ligjet e organizimit të njërezve të këtyre kanalëve.

Zgjedhësit :- të përjashtuar nga zgjidhjet e mundshme

Zhvillimet politike në vend, ku administruesit e pushtetit të dalë nga vota e popullit po e përdorin atë si pronë private dhe ku opozita nuk vepron politikisht brenda institucionëve që afirmojnë demokracinë, janë një tregues se votuesi pasi e jep votën nuk mund të ushtroj kontroll mbi të zgjedhurin e tij, ose e thenë ndryshe është i pafuqishëm para abuzimit me të.

Zgjedhësit po e humbasin shpresën se politika dhe shteti mund t'u shërbejnë edhe atyre Njëkohësisht situata e sotme politike i kujton zgjedhësit shqiptar se përderisa nuk arriti të shkëlqente mentalitetin qeverisës as me mjete ekstreme që përdori me 97-ën, e ka të vështirë të bëjë diçka më të mirë sot. Ndaj po ndërgjegjesohet se më shumë rëndësi ka të gjej me çdo çmim një vrimë për të jetuar se sa të përpiqet të kujtojë shtetin të mendojë edhe për të.

Defermomimi i shtypit.

Eshtë thenë me mburje të ligjshme se një nga arritjet e demokracisë shqiptare ishte shtypi i lirë i shkruar. Por identifikimi i tij para 1997, me interesat e opozitës, madje deri në zëvendësimin e rolit të saj, konkurenca e ashpër e medjës elektronike pas kësaj periudhe dhe nevoja për të mbijetuar, e kompromentuan misionin real të një pjese të mirë të shtypit. Si rezultat, fuqinë e pushtetit të katërt shtypi e ktheu në faktor

ndërmjetës për t'u bërë pjesë e ingranazhëve të politikës dhe e kanaleve të tjera që prodhojnë fitime të majme.

Kështu në situatat e sotme ai fiton rol në shërbim të konsolidimit të interesave të grupeve politike duke manipuluar opinionin publik, **ose duke e çorientuar nga problemet reale**. Thellimi i këtij fenomeni, pas pikëpyetjeve që i vunë vetës pushtete e tjera, është e sigurt që do të çojë në deformime të reja të demokracisë shqiptare.

Argumentat e Metës për krizën

I ardhur në nivelin politik të kryeministrit si pasojë e kompromisëve fituese ndaj kryetarit Nano, Ilir Meta duket se nuk di të bëjë kombromise që mund ta vendosin në pozicionin e humbësit qoftë edhe përkohësisht apo pjesërisht. Ose, njëherë rreth tij po e përdorin për mburrojtje për të shpëtuar vetën e tyre. **Fjalimi i tij para qeverisë në ditët e para të vitit të ri e verteton më së miri këtë**. Si do që të jetë më këtë qëndrim po kompromenton keq brezin e ri të politikanëve shqiptar.

Meta duke e konsideruar vetën të pazëvendësueshëm deri tani nuk e ka pranuar krizën edhe pse strukturat e partisë, dorëheqja e katër ministrave, bllokimi i parlamentit **dhe i presidencës , pamundësia e shtetit për t'u ardhur në ndihmë të bllokuarve nga dimri**, nuk janë të mjaftueshme **për Kryeministrin për ta evidentuar atë** .

Në një aspekt tjetër, herë i referohet nevojës së stabilitetit të brendshëm dhe atij të rajonit, në një kohë që dihet se roli i Tiranës është dytësor, herë i referohet mbështetjes që ai gëzon nga faktori ndërkombëtar, në një kohë që po kalojnë muaj dhe çdo ditë e më shumë po izolohet diplomatikisht.

Teza e re e tij se integrimi evropian i Shqipërisë përbën sfidë kombëtare, është e vertetë, por faktorët e tjerë politikë, të brendshëm dhe të jashtëm, tregojnë se për këtë sfidë nuk mund të jetë garante qeveria që drejton Meta.

Ndërsa me pretendimin se minoranca bllokuese e Nanos po krijon precedentin e krijimit të grupeve të tjera bllokuese Meta verteton se jashtë institucionit të kryetarit aktual të PS-së nuk ka asnjë mjet tjetër garant që interesat globale të PS-së të mos u nënshtrohen interesave individuale.

Pse Nanua nuk e hodhi dorëzën në gusht

Pas trafikut të konstatuar të votave brenda në KPD në gushtin e kaluar, Nanua e kishte të drejtën morale të ndërmerre një hap të tillë. Hapja atëherë e një ballafaqimi të brendshëm në PS, në kushtet e një procesi të stërgjatur dhe të diskutueshëm zgjedhor, do të çonte në një destabilitet real politik në vend. Njëkohësisht ai i dha Metës shansin për të reaguar në shërbimin e semundjeve të renda të korrupsionit e trafikëve. Brenda një kohe të shkurtër po ndodhte e kundërta. Në këtë plan Fatos Nano ecën paralelisht me faktorin ndërkombëtar që e lidh stabilitetin politik në vend **si më luftën kundër krimit të organizuar ashtu edhe** me mosprovokimin e zgjedhjeve të parakohshme.

Meta luan në favor të Berishës, Nanua të PS-së

N.q.s edhe Nanua do të pajtohej me situatën **për hir të një** kompromisi me Metën shumë shpejt dhe shumë lehtë qeveria do të rrezohej dhe do të provokojeshin zgjedhje të parakohshme. Rezistenca e stërgjatur e Ilir Metës, po e lodh dhe e gangrenizon situatën. Hedh në erë të gjitha mundësitë e bashkëpunimit brenda PS-së dhe krijon terren që opozita e Sali Berishës të imponojë rregullat e veta. **Vet formula që servir ditët e fundit Sali Berisha për tri faktorë primar politik në vend, (Nano, Berisha, Meta), bashkë me papajtueshmërinë e deklaruar për bashkëpunim institucional, verteton pikërisht këtë synim të Berishës**. Në rast se ndodh kështu atëherë PS-ja e ndarë , juridikisht apo faktikisht, do të konkurrojë shumë shpejt për të qenë opozitë, e parë, e dytë apo e tretë njëkohësisht.

Në kushte normale kjo do të ishte pasojë për PS-në, dhe jo ndonjë hata e madhe për vendin. Problemi qëndron në faktin se opozita e tanishme duket se nuk ka

rikuperuar mentalitetin e qeverisjës që e rrezoi nga pushteti dhe po bren sot edhe PS-në. Po ashtu ajo nuk është çliruar dhe reformuar nga mentaliteti i administrimit të pushtetit si hakmarrje politike duke e përmbyllur kështu jetën politike shqiptare në të gjitha nivelet në rrethin vicioz të hakmarrjeve politike, e duke kryqezuar për një kohë edhe më të gjatë perspektiven demokratike në vend.

Kongresi apo referendumi.

Si referendumi ashtu dhe kongresi janë mjete e fundme të inisiativave në duart e Nanos. Por ato veç përfitimëve në kohë nuk mund të sjellin zgjidhjet e derisotshme të konfliktëve të vazhdueshme në PS. Si të tilla përbejnë skenat e fundit të aktit të fundit.

Referendumi nga vet karakteri i tij ka një favor për PS-në ndaj kongresit. Duke qenë se në të do të votohet, me po ose jo, për platformën e Nanos lidhur me mënyrën e qeverisjës (ndoshta pa përfshirë Metën) krijon kushtet e shmangjes së një përçarjeje eventuale.

Kongresi nga ana e tij si forum që mund të marrë në shqyrtim të gjitha strukturat e partisë është e sigurt se do të krijojë predispozita përjashtuese për njërin ose për tjetrën palë.

Duket se Meta është përgatitur për përplasjen përfundimtare me Nanon në Kongres. Kjo është arsyeja që Meta e kërkon me urgjencë mbledhjen e kongresit. Hovin e tij mund ta presin dorëheqjet e pritshme të ministrave të tjerë

Por edhe në ndodht që Meta të fitojë ndaj Nanos në kongres, PS-ja do të dalë e humbur. Dihet se pas një rasti të tillë Fatos Nanos do t'i mbetet si rrugë e vetme për të provuar drejtësinë e tezave të tij, krijimi i një partie të re socialiste. Karisma e tij, të qenit kryetar që nga themelimi, përvoja e gjatë, lidhja e tij me bazën e PS-së, përbejnë garancitë që Nanua të marrë pas vetës pothuaj gjithë PS-në e tanishme. (në këtë rast nuk mund të ndodh si me PD-në kur kryetari impononte largimin e kuadrove të tjerë) Pas kësaj, nuk duhet pritur zgjedhja e presidentit për të besuar në zgjedhjet e parakohshme. **FUND**

Nga Panajot Barka

Partia Socialiste në rrrathë krizash

07.02.2002/09.02.2002

Aktet e fundit të krizës në PS tregojnë se ajo sapo doli nga një rreth krize mund të hyjë në një rreth tjetër krize, duke krijuar njëkojesisht premisa për zgjidhje të tilla ku asnjëra nuk mund të kenaq aspiratat e deklaruara për unitetin e familjës socialiste.

Nga ana tjetër vendi mbetet i mbërthyer nga dy spirale krizash. Kriza politike dhe kriza ekonomike. Kriza ekonomike është produkt i qeverisjës së keqe, ndërsa kriza politike nuk është pasojë e krizës ekonomike por produkt i brendshëm i vet politikës. Fakti që mbartësit e krizës ekonomike nuk reagojnë për të imponuar politikën që të ndërhyjë për ndërprerjen e saj, flet qart se ata, kanë humbur besimin tek politikanët e tyre. Po ashtu janë ndërgjegjesuar për një realitet të pamohueshëm. Se politika në gjendjen e saj kritike nuk mund të ndërhyjë për të shmangur krizën e thellë ekonomike, ndaj dhe zgjedhësve nuk u interesojnë fort zgjidhjet e krizës politike.

Situata e krizës politike është reflektim veprimit të kimit të organizuar, kimit ekonomik, abuzimit të pushtetit, elementit terrorist, etj me një prapavijë politike. Si pasojë, kriza politike ka në thelb përplasjen midis tendencës së këtyre segmentëve për të kontrolluar pushtetin dhe veprimit të faktorëve të ndryshëm për të penguar këto fenomene. Në fakt ajo shfaqet si rezultat qëndrimesh subjektive që burojnë nga mentalitete ballkanase të aktorëve kryesorë të politikës shqiptare. Po ashtu edhe zgjidhjet për të identifikohen me shfaqjen e krizës duke krijuar premisa për riciklim me amplitudë me të thellë në të ardhmen.

Është e vertetë se nga fenomene të njejta nuk shpetuan shumë vende të botës. Atje ku ato nuk u shmangen nga institucione të organizuara apo dhe nga individë të veçantë si në Itali, u shoqëruan nga fenomene të tjera dekompozuese të politikës dhe shkarjen drejt juntave, si në Greqi, apo në anarki. Megjithatë çdo rast u pasua një kualitet të ri politik që i dha frymëmarrje të gjerë shtetit dhe pushtetit politik

Tek në këtë rol e përfaqëson lëvizja Nano. Ajo më shumë se një levizje katharsis në kuptimin e mirfillt klasik të fjalës, si vetpërsosje morale e shpirtërore e shkaktuar nga perceptimi i realitetit të formësuar artistikisht, duhet kuptuar, ose duhet kthyer si lëvizje që kërkon të shpetojë politikën në përgjithësi nga mekatët e korupsionit, kimit të organizuar e aferave ekonomike me pjesëmarrjen e drejtpërdrejt apo të kamufluar të politikës. Në këtë aspekt kjo lëvizje është e destinuar të shkojë deri në fund me apo pa Nanon.

Në pikëprerjen e të gjithë këtyre rrrathëve na shfaqet zgjidhja Majko. A do të mundet ai të kthehet në një katalizator veprimi të trefishtë. Të bëhet pjesë komplementare e lëvizjes Nano, të ndërhyjë për shmangjen e krizës ekonomike dhe për të arritur mbi këtë bazë konsensualitetin në funksionim e PS-së? Në një plan të parë, Majko nuk mund të sjell zgjidhjen thelbësore të kësaj krizës, për arsye se si Pandeli Ai, si Ilir Meta, nga pozicioni i kryeministrit, janë pjesë e ciklit në thellim të qeverisjës korruptive të pushtetit ekzekutiv të PS-së. Aq më keq që Majko u thirr në skenën e zgjidhjes së krizës nga Ilir Meta dhe u votua në KPD si një mjet për të demonstruar forcën e secilës palë në forumin e PS-së. Në këtë aspekt, po të kemi parasysh pozicionin e liderit që mori Meta në KPD dhe shpalljen hapur të luftës kundër Nanos për ta zëvendësuar atë në krye të partisë, roli i Majkos për të zgjidhur krizën veshtirësohet edhe më. Me dashje ose pa dashje ai ka rrezik të mbetet peng i përplasjes së grupëve Nano – Meta në parti .

Meta ndoshta e përdori kartën e Majkos kur dihej kontestimi i Nanos për çdo propozim i ardhur nga Meta, për të krijuar një aleancë të fortë në luftën ndaj Nanos. Me

këtë propozim Meta në emër të konsensusit të kërkuar, e nxorri Majkon nga pozicioni i përfaqësuesit të unitetit në PS. Pra Majkos përpos të tjerave tani duhet të përballojë dhe përpjekjen e Metës për ta aktivizuar atë në favor të tij. Gjithashtu, kjo do të thotë se marrëdhënjet bilaterale Meta – Majko, i dyti u spostua nga rruga e ambicjeve të Metës për në kreun e partisë.

Por as konsesin e premtuar nuk do ta realizojë dot Majkua. Nga njëra anë do të jetë nën presionin e njërëzve të Metës për të ruajtur vazhdimësinë, por më shumë për shkaqe interesash që do të lenë në mes lëvizjen antikorrupsion, nga ana tjetër do të ketë presionin e bojkotimit apo të kontestimit të palës tjetër që do të ngrihet në emer të thellimit të antikorrupsionit.

Kështu Pandeli Majkua, jasht logjikës së rolit të katalizatorit të trefisht, ka rrezik që nga pikëpamja personale të humbas në mos të terrën, një pjesë të investimit të vet politik sidomos atë të periudhës pas 1999ës, ndërsa PS-ja humbet në favor të përplasjes së pafund, një investim të konsiderueshëm në favor të ruajtjes së ekulibreve të unitetit të saj të brendshëm. Majko pra ka rrezik të kthehet në pjesë e njëres palë për të kontribuar në favor të saj nga pozitat e kryeministrit, ose të humbas në përplasjen e të dyjave

Nga kjo pikëpamje dhe pozicioni i Nanos është vështirësuar sëtëpërmi. Mentaliteti i krijuar, lidhur me shkaqet dhe shkaktarin e krizës, pa parë kurrë thelbin e saj, personaliteti i Majkos, si dhe propozimi dhe përkrahja e Metës drejt postit të kryeministrit, çojnë çdo vendim të liderit socialist për ta kontestuar ose jo Majkon, në keqinterpretime me pasoja të rënda, për PS-në. Kjo do të thotë se n.q.s Nano nuk do të arrijë t'i imponjë Majkos platformën antikorrupsion dhe në emer të jetëgjatësisë se qeverisjes socialiste, apo për të rigrupuar forcat, ta përkrahë atë, thelbi i krizës do të mbetet i pacenuar. Për shkak të këtij qëllimi vemendja do të spostohet në luftën e karrigëve duke e bërë atë më të ashpër. Pikërisht kjo luftë dhe faktori final “zgjedhje të parakohshme”, përbëjnë sinonimin e humbjes së pushtetit nga PS-ja dhe bëjnë të pavlefshme përpjekjet për të imponuar zgjidhje të tjera për kapërcimin e krizës së vet PS.

Panajot Barka Gjirokastër 07.02.2002. U botua tek Gazeta Shqiptare 2 dite me vonë

Nga Panajot Barka

Rrerthi vicioz i krizës në vend

15.03.2002

Shoqërimi i përpjekjeve të stërmundimshme për të zgjidhur krizën disaplanëshe në vend nga shpërthime episodike krizash që tendojnë ta mbajnë të frenuar zgjidhjen e dëshiruar, tregon fatkeqësisht se përrjetojmë momente mitike me Hydrën nëntëkokëshe. Politikisht kjo do të thotë se vendi është mbërthyer nga rrathë viciozë krizash ku çdo përpjekje për të goditur dhe prerë një të tillë shpërthejnë të tjerë, më shumë ose më pak të rrezikshëm.

E keqja është se shoqëria në përgjithësi është kthyer në një terren shumë të përshtatshëm për konfortin e rrathëve viciozë të krizës (baltovina Lerneane e Hydrës) dhe nuk arrin të krijojë kushte për veprimin e faktorit “asgjësues” të këtyre rrathëve (Herkulin), dmth një sistem politik dhe demokraci të qenësishme.

QEVERIA MAJKO – NJË ZGJIDHJE OPTIMIZMI MË SE TË PËRMBAJTUR

Që pa marrë votbesimin Qeveria e Majkos mbeti robinë e dilemës për jetëgjatësinë e saj e shkaktuar nga kriza e mbetur ngrehur në PS dhe shpërthimi i krizave të reja në parlament për zgjedhjet e kaluara dhe çeshjtën Rakipi. Këto dhe të tjera bishta përplasjesh e krizash konturojnë përplasjen me kritike në të ardhmën e afert,- atë të zgjedhjes së Presidentit.

Edhe optimizmi se gjerat kanë filluar të ecin, i shkaktuar nga fakti se mosqeverisja disajavore dhe de jure i vendit , nuk u shoqërua me trazira, është iluzion. Mungesa e trazirave vertetoi në fakt se qarqet që mund të shkaktojnë trazira u përkasin sferave të larta politike e shtetërore. Këta janë të ndërgjeshëm se inkriminim e tyre nuk mund ta shpëtojnë me trazira. bn Aq me tepër pozitativ e arritura për të dominuar dhe kontrolluar shtetin. Trayirat mbetën si fisheku i fundit kur nuk japin rezultat rikalkulimi dhe sofistikimi i pozicionëve për të mos u goditur nga institucionet e shtetit. Sido që të jetë interesat e këtij lloji në nivelet e larta të politikës dhe të strukturave të shtetit, të shfaqura në publik me korelacione politike, shkaktojnë në mënyrë të pashmangshme përplasje të ashpra dhe të rrezikshme.

Por lë të mos harojmë se braktisja në masë e foshnjave të porsalindur, vetvrasjet e shumta midis moshave adoleshente dhe të reja, shitja e vlerave njërezore që faktikisht përbejnë tabu të pashitshme, shkatërrimi i institucionit të familjës, nuk flasin thjesht për shkallën e rëndë të krizës, por trazira me kosto dhjetëfish më të lartë se shkatërrimi i godinave.

MOCIONI RAKIPI DHE KONTEKSI I RRATHEVE TË KRIZES

Mocioni i mosbesimit për Prokurorin e Përgjithshëm përbën përbën rastin më evident. Së pari, përbën njërin nga aktet që do të ndërmarren opozita për të arritur në favor të qëllimëve të veta, prishjen e ekuilibreve pozitë-opozitë në parlament në lidhje me qeverisjen në vend, si dhe precedentin për të venë në diskutim dhe institucione te tjera shtetërore kur ato nuk i shërbejnë një grupi të caktuar apo interesave të caktuara. (Pas mosnjohjes se Kushtetutës, parlamentit, rradhën e ka Gjykata Kushtetuese dhe pastaj vet qeveria). Së dyti, opozita shpreson të sigurojë edhe mbrojtjen e saj dhe të akuzuarve të tjerë në kampin e qeverisjes duke i kompromentuar këta të fundit për t'i imponuar në vijim bashkveprim jo fluid por real. Se treti krijon mundësitë e duhura për të manipuluar opinionin me alibi, kundëruaza e akuza për hakmarrje politike. Njëkohësisht brenda mazhorancës kriza disa mujore do të vazhdojë të mbajë të ndezura urat.

Në çdo rast tjetër mjeti më i provuar dhe efikas për të gjetur një zgjidhje për situatën janë zgjedhjet e parakohshme. Në rastin tonë rrathët viciozë të krizës nuk e lejojnë këtë

zgjdhje. Kjo pasi jo thjesht pengesat për rregullimin e sistemit ligjor të zgjedhjeve presupozon ri ciklimin e të njejtave fenomene, por se presupozon ardhjen në pushtet të opozitës në kushtet e një paralize totale Dhe se opozita e sotme kërkon të vij në pushtet duke mbajtur të gjallë dhe vepruese një situatë të tillë. Po të marrim parasysh faktin se ajo vet u hoq nga pushteti për shkak të situatave të përngjashme për në një shkallë më të thellë, kjo do të thotë se zgjedhjet e parakohshme në vend të zgjedhjes së krizës mund të çojnë në një rokade të re portash, pra një riciklim të hakmarrjes politike dhe të njejtave pasojave të rrahëve viciozë të krizave.

E keqja e stadi të tanishëm të krizës në vend është humbja e durimit dhe nevrifikosja e perendimorëve dhe fakti që politikanët shqiptarë nuk kanë as ndërgjegje për realitetin e as memorje historike për pasojat e mundshme në rast braktisjeje.

RRATHET VICIOZË TË KRIZAVE DHE KRIZA E VLERAVE TË SHOQËRISË

Zhvillimet e fundit tregojnë gjithashtu se mentaliteti politik, intelektual dhe civil në vend nuk interesohet për thelbin e çështjeve, por bllokohet në mënyrën si shfaqen. Nuk përpiqet të krijojë terrene stimuluese për veprime që janë qoftë edhe domosdoshmerisht të drejta por kthen kokën prapa për të gjetur njollat e murme në biografi të personazheve veprues dhe me këto njolla të provokojë veprime që komunikojnë me të shkuarën dhe jo më të ardhmën. Shoqëria civile shqiptare është viktimizuar në këtë plan nga shtetarët e vet të cilët vlerat e krijuara nga shoqëria i kthen vazhdimisht në antivlera. Ky fakt provon fatkeqsisht deshtimin e radhës së Perendimit. Investimet kolosale për OJQ-të me qëllim ngritjen dhe funksionimin e shoqërisë civile shqiptare nuk dhanë rezultat dhe po konstatohet se ato janë kthyer thjesht në vrime të zëza.

Fakti që mocioni i mosbesimit ndaj Prokurorit të Përgjithshëm shfaqet në momentin që sapo nisi veprimi i tij institucional mbi krimin e organizuar nuk kërkon komente. Në situatat në të cilat ndodhet vendi çështja që shtrohet është që shteti të veprojë. Nuk ka rendesi në se Prokuroria e Përgjithshme filloi me vonesë të veprojë. Nuk kanë shumë rendësi motivet që detyruan Rakipin të veprojë. Rendësi ka që nisi një proces i domosdoshëm. Ashtu siç ka rendësi që faktorët e tjerë politikë, civilë e intelektual, të brendshëm apo të jashtëm, të angazhohen që ai as të jetë e as të kthehet në levë politike në duart e dikujt, as ta perdorin e as të prdoret, por t'i sherbejë institucionit, ligjit e kushtetutës.

E njejta gjë duhet thenë edhe me levizjen Nano. Kur kjo levizje nisi si domosdoshmeri civilizuese e emancipuese e jetës politike e shoqërore në vend, nuk u vu re aq angazhimi për ta bërë atë promotor. Qoftë edhe pa Nanon, apo kundër dëshirës së tij. Më shumë u evidentun rezervat për të dhe hulumtimi për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ndenja për kureshtjet e grave. Në thelb u harxhuan dhe harxhohen energji kolosale për ta minimizuar Nanon dhe për t'i imponuar levizjes së tij deshtimin madje me shkakuar vet atë.

E sikur të mos mjaftonte kjo. Në një kohë që jeta shqiptare ka nevojë për kontributin e intelektualëve që të orientohet drejt për përballimin e përmasave të krizës, klasa intelektuale harxhon energjitë e mbetura për të provuar një të vertetë që "Pashallarët e kuq", nuk ishte poezi disdente.(!)

Dhe po të mos egzistonte situata e krizës, vertetimi i disidencës inegzistente kadariane nuk i sherben askujt. Fakti plotëson imazhin se shoqëria jonë qoftë edhe intelektualët nuk janë të gatshëm për të krijuar vlera e simbole që frymëzojnë qendresë, rezistencë dhe perspektivë por vetpersekuacion.

Kjo të kujton edhe njëherë realitetin tonë që historia e këtij vendi, vlerat kulturore dhe gjithçka tjetër të prodhuar në shekuj, është dashur gjithmonë të kerkohen në rrenoja dhe shkatërrime. **FUND 15.03.2002.**

Nga Panajot Barka

Raundi i parë i zgjedhjeve lokale dhe realiteti i vështirë politik.

14.10.2003

Raundi i parë i zgjedhjeve lokale u mbyll me një zhgenjim të plotë për të gjithë ata që parashikuan një ditë tensioni në Shqipëri. Po ashtu zhvillimi i zgjedhjeve të një Tetorit u jep të drejtën që të krenohen gjithë atyre që u përpoqën dhe kontribuan për zgjedhje të drejta, të lira korrekte dhe demokratike. Me këto parametra u percaktuan madje edhe fitimtarët dhe humbësit. Pas kësaj duket se faktori ndërkombëtar do ta vlerësojë me notë pozitive të lartë procesin demokratik në Shqipëri, aq më tepër do ta bëjë këtë vlerësim ai segment i faktorit ndërkombëtar që u mor drejtpërdrejt me procesin elektoral në Shqipëri.

Mëgjthate faktori i brendshëm politik në fakt nuk e kaloi këtë test më të njëjtin vlerësim.

Së pari. Gjatë fushatës elektorale partitë politike sidomos dy partitë e mëdha P.S.-ja dhe P.D.-ja e harruan shumë shpejt testin e perendimit që këto zgjedhje më shumë se vlerë për percaktimin e fituesit do të shërbenin si një barometër për stabilitetin politik dhe gjenerimin e vlerave demokratike në vend.

Këto parti fitorën e kthyen në qellim në vetvete d.m.th si treguesin më të mirë për fituesin e zgjedhjeve të përgjithshme të 2001. Ky qellim në vetevete risolli tensionimin e situatave me fjalorin banal dhe akuza të rënda sa që të dukej se pas fushatës elektorale nuk do të mjaftonin të gjithë prokurorët e republikës për t'u marrë me politikanet.

Se dyti. Fushata nuk ishte një ballafaqim programesh por një ballafaqim kundërshtarësh. Ashpërsia e kësaj përplasjeje si dhe qëndrimi ndaj rezultatit nga ana e humbësit, verteton se luajaliteti dhe bashkëpunimi pozitiv – opozitiv si faktor të konstruktivitetit demokratik është vështirë të mendohet, pa lë të arrihet. Në këtë kontekst në një përpjekje për të grumbulluar rreth vetës sa më shumë elektorat u thirr fatkeqësisht në skenë faktori Berisha aq sa mund të thuhet se ai pushtoi të dy partitë kryesore në të majtë si antiberishë dhe në të djathtë si antiPD

PS ja në këto zgjedhje vendosi veten në pozicionin real që kishte në lidhje me pushtetin lokal, në atë të opozitës. Në betejën elektorale për të fituar ajo perdori antiberishizmin madje shpesh deri në ekstreme të logjikës dhe të fjalorit banal të trotuarëve. Por lë të mos harrojmë se PS-ja e përdori këtë kartë nga pozitë e të qenit pozitiv në pushtetin qëndror dhe ky fakt është me kosto politike jo aq të ulët si brenda ashtu deh jasht vendit.

Është e vertetë se Berisha e terhoqi gjithë pozitën në logjikën e vet elektorale pavarësisht se provokonte një antiberishizëm shpesh më të skajshëm se akuzat ndaj saj nga ana e Berishës. E vertetë është gjithashtu se Berisha në formën e antiberishizmit u bë faktori për sheshimin e kontradiktave midis grupëve dhe klanëve të ndryshme brenda udheheqjes së PS-së. E thenë ndryshe. Nevoja e ruajtjes së pushtetit dhe frika se mos Berisha i bënte realitet kërcenimet e veta në rast fitoreje e kthyen atë në një faktor unitetit për udheheqjen e PS-së, pavarësisht si antiberishë. Por kjo ama nuk solli atë që i duhet PS-së,- shtimin e radhëve të votuesve të saj.

Fenomeni Berishë u kthye në një antiPD edhe në kambin e partisë së tij. Nga njëra anë ai edhe një herë barazoi në personin e tij gjithë Partinë Demokratike.

Kështu pas ikjës se grupit të fundit kundërshtar nga radhet e veta, ai i reformatorëve, evidentimi i vetëm i tij në të gjitha aspektet politike të partisë asimiloi dhe zvogëloi kapacitetin intelektual e politik të PD-së dhe e denigroi atë në të bërta Ky rol i shkoi përshtat Berishës më 1997 kur Partia Demokratike u rudhos së tëpërmi dhe arriti të mbijetojë në saj të energjive të tij dhe nevojës për një opozitë në Shqipëri. Dramaciteti i atehershem tani është kthyer totalisht në komizem që një fije peri e ndan nga marrezia tragjike.

Nga ana tjetër aplikimi pikërisht si një logjistikë propagandistike, për të shtuar elektoratin e vet, të një fjalori renqethës me burgje, ruspa, gjyqe publike, etj jo vetëm që i hoqi atij besueshmërinë e faktorit opozitë dhe të fakteve kompromentuese të serviuara kundër pushtetarëve, por trembi në një masë shumë të madhe pasuesit e vet dhe riktheu në kampin e socialistëve të gjithë të pakënaqurit nga qeverisja e PS-se, ose i hodhi në “partinë e intefernetëve”.

Faktori i tretë negativ i fenomenit Berishë ndaj partisë së vet është fakti se Berisha është tani humbësi i madh për partinë Demokratikë. Berisha faktikisht pas zgjedhjeve të përgjithshme të 1992 ka humbur të gjitha betejat elektorale, gjithsej shtatë Mëgjthatë ai vazhdon të jetë në krye të PD-së, gjë që nuk ka ndodhur me asnjë parti në botë.

Kështu antiberishizmi I PS-së me akuza të rënda penale politike e ordinere, por vetëm për konsum publik dhe jo për zbatimin e ligjit tregoi tre gjera: Alternativa e PS-së për fitore kishte sensin mohues të një realiteti të rimohuar edhe më parë. PS-ja nuk e kupton rëndësinë e një opozite konstruktive Me kartën antiberishë shtoi edhe ajo radhet e “partisë së intiferentëve”

Ndërsa antiPD-ismi I Berishës theksoi domosdoshmërinë e rimekembjes së PD-së dhe më gjerë të opozitës.

Se treti **Meritat e faktorit popull përvetësohen nga partitë politike.** Po provohet edhe një herë se partitë u nderuan me zgjedhjet për arsye se votuesi popull nuk pranoi rrugën e klimës së nxehtë politike dhe të trazirave që I imponuan gjatë fushatës elektorale partitë politike .Ai zgjodhi rrugën e qetësisë, tolerancës dhe paqës. Populli u tregua sovran I vertet me votën e tij. Por meritën për këtë arritje të tij do ta përvetësojnë partitë politike duke deklaruar “se zgjedhjet e lira korrekte e demokratike të 1 tetorit” ishin produkt I tyre. Se sa e vertet është kjo e treguan rezultatet e para dhe ato që pasuan ku humbësit ngritën krye me akuza për “manipulime totale” dhe mosnjohje të tyre duke e riacaruar situatën aq sa dhe balotazhi në një numër relativisht të lartë komunash dhe bashkish nuk do të mund të shërbejë si një amortizator kundër këtij fenomeni të origjinës politike pluraliste shqiptare.

Po ashtu popullit nuk do të vijë keq për këtë përvetësim vlerash se sa për faktin që partitë nuk marrin dot mesazhin se ai duke minimizuar shkallë shkallë pjesëmarrjen në votime u tregon se ka humbur besimin në to, se kërkon diçka të re. “Partia e intiferentëve” në këto zgjedhje po të bejmë llogari reale, del në fakt partia fituese.

Këtë në fakt e tregon edhe balotazhi në shkallë të gjerë ashtu dhe përpjekja e partive të vogla për të sfiduar dy partitë e mëdha . Por në fakt populli nuk u beson fort atyre se asnjëra nga partitë e vogla nuk rezistoi në rolin e opozitës dhe të vlerave të saj për një kohë të gjatë, por në çdo rast e shfrytëzuan rolin opozitar për t u bere pjesë përbërëse e pushtetit .Pra populli I shikon si imitime të dy të mëdhenjve, ashtu si

i shikon si bashkfaqtorë të gjithë individët apo grupe individesh që largohen prej këtyre partive si opozitarë .

P BARKA Për gazetën Shqiptare e martë 14.10.2003

Nga Panajot Barka

Zgjedhjet lokale, pozita dhe perspektiva e liderit të ri të opozitës

07.01.2007

Politika, si aspekti më i rëndësishëm i jetës në vend, e mbylli 2006-ën duke lenë në fuqi krizën me të rendë elektorale në vend. Në plan të parë ajo duket thjeshtë teknike, ose e stimuluar nga kapriçio personale apo të grupit. Në fakt është me e thellë. Ajo i kapërxën kufijtë e frikës të një fitoreje të manipuluar dhe prek drejtpërdrejt konceptin e demokracisë, në të cilën respekti për parimin e votës së lirë e lidhet me funksionin jetik për të, atë të rolit të pozitës dhe të opozitës.

Në këto rrethana, thelbin e krizës politike të zgjedhjeve të tanishme lokale në vend mund ta kuptojmë vetëm duke përqasur situatën e tanishme politike me atë të zgjedhjeve lokale të verës së vitit 1992. Të dy këto momente konfigurojnë në mënyrë diakronike mentalitetin politik të lidërshiptit të sotëm dhe të atëhershëm në mazhorancë për të drejtuar vendin pa opozitë, ose me një opozitë të dobësuar deri të nxjerrë jashtë loje politike.

Zgjedhjet e atëhershme lokale u zhvilluan kur në pushtet prej disa muajsh ishte mazhoranca e tanishme. Ato u shoqëruan me burgosjen politike të liderit të opozitës së atëhershme Fatos Nano. U akuzua thjeshtë për korrupsion. Synimi që i qartë. Opozita e atëhershme që mbarte mbi supe peshën e rendë të trashëgimisë komuniste, duke pasur në burg liderin e vet, të trembej dhe të shpartallohej totalisht. Në fakt ndodhi e kundërta. Tani ndodhemi serish në të njëjtën situatë. Pozita e sotme e mbeshtetur ose e varur totalisht te i njëjti lidërshipt politik, është në pushtet prej një viti e disa muaj. Brenda kësaj periudhe po vërtetohet se ajo nuk tërhiqet nga përpjekjet për të kontrolluar institucionet e pavarura të shtetit dhe për të pasur një opozitë inegzistente. Përsa i përket dobësimit të opozitës, mazhorancës do t'i mjaftonte konsequenca praktike e parullës politike elektorale:- lufta kundër korrupsionit të opozitës dhe në qeveri. Mirëpo provat treguan se kjo luftë e bashkoi më fortë opozitën, (edhe pse shpesh për të mbrojtur interesat personale) dhe e bëri me të ashpër luftën ndaj qeverisjës së liderit të mazhorancës së sotme. Nga ana tjetër, mazhoranca duket se e kuptoi që konsequenca për një kohë të gjatë në këtë luftë do t'i hiqte realisht asaj mundësinë për të përfituar personalisht me të njëjtën mënyrë. Në këto rrethana lideri politik i mazhorancës, duke u nisur nga mënyra e vet e drejtimit, (duke përqendruar në mënyrë absolute në dorën e tij të gjitha kopetencat), shikon si mundësi të vetme dobësimi të opozitës nxjerrjen jashtë loje të liderit të saj E.Rama. Rast më të mirë nuk ka se sa humbja e drejtpërdrejtë e tij në rikadidimin për në krye të bashkisë së kryeqytetit.

Përveç kësaj lideri i mazhorancës, Berisha, ka edhe disa arsye të tjera për ta kthyer këtë betejë elektorale në qëllimin më të lartë politikë të tij. Lideri i sotëm i opozitës, në kuadrin kohor që e drejton atë, ndonëse nuk arriti ta sherojë partinë e tij nga semundjet e renda, pasojë e abuzimit me pushtetin politik të qeverisjës, pati merita në planin anti-Berishë. Arriti ta frenojë ose ta kthejë mbrapshtë atë, pothuajse në të gjitha inkursionet politike në dem të opozitës dhe kontrollit të strukturave të pavarura të shtetit. Ndryshe, pra nga raporti Berisha – Nano ku palet ishin reciprokisht komplementarë, ku Nano i lëshonte Berishës pjesë nga pushteti i tij i pafund i siguruar pas trazirave të 1997, raporti Rama - Berisha ka në thelb antiberishizmin, në emer të ruajtjes së standarteve në drejtimin e shtetit.

Një humbje e Ramës në luftën për kreun e bashkisë së Tiranës, do të thotë të lëkundet deri në palcë autoriteti i tij në krye të opozitës, autoritet ende i pakonsoliduar dhe me brerje të brendshme serioze. Pra, opozita do t'i rihynte procesit të njohur për rigjetjen “e liderit të padiskutueshëm”, fakt që do ta fuste në një rreth vicioz të pafundëm. Drejt

këtij synimi Berisha ka me siguri mbeshtetjen e heshtur të faktorit opozitë brenda opozitës, i cili ose ka renë nga fiku, ose ka synime të hapura për të marrë drejtimin e opozitës, ose të posteve të larta shtetërore të cilat arrihen vetëm me ndihmën e Berishës. Zvogëlon gjithashtu premisat lidhur me tezën e hedhur se pas Nanos i vjen radha Berishës për të dalë në pension politik.

Kjo, jo vetëm do ta shpetonte Berishën nga frika e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, aq të përfoluara dhe aq të mundshme, por do t'i siguronte atij zgjatjen e mandatit qeverisës dhe mbi të gjitha një liri të pakontrolluar në drejtimin e vendit dhe të shtetit. Vetëm kështu mund të kuptohet “lufta” e shpallur për marrjen e drejtimit të kryeqytetit.

Berisha e deklaroi i pari dhe që në fillim këtë qëllim. Betejën për Tiranën e shpalli si humbje të domosdoshme të kryetarit të opozitës. E lidhi krizën “vetëm me një njëri” dhe “ky quhet Edvin Rama”. E thjeshtoi problemin me nevojën e këtij të fundit për të “fshehur korrupsionin dhe lidhjet me bandat kriminale”.

Por, problemi nuk është aspak kështu. As nuk lidhet thjesht me terrorin verbal të liderit të mazhorancës kundër kundërshtarit politik. As me faktin se Rama ka nga mbrapa një vepër të admirueshme në krye të punëve në kryeqytet që tremb çdo kundërshtar në ballafaqimin me të. Problemi lidhet me shumë me imazhin që krijohet për foshnjërinë e demokracisë në vend që buron nga koncepti i mazhorancës për të drejtuar pa kundërshtarë.

Edvin Rama është lideri i opozitës dhe jo thjeshtë një kryetar bashkie apo një figurë tjetër e çfarëdoshme. Përderisa ai, si lidër i opozitës pranoi sfidën për të pretenduar qëverisjen e bashkisë së Tiranës, mazhoranca duhej të kafshonte buzën dhe në respekt të opozitës të pranonte edhe ajo sfidën. E kundërta është moralisht e denueshme. Në asnjë vend të botës nuk ndodh që një forcë politike, aq me pak mazhoranca, të grumbullojë të gjitha forcat e mundshme, të ligjshme dhe të paligjshme, të ndërshe dhe të pandërshe, me qëllim që të mund kryetarin e forcës politike kundërshtarë, aq me keq kryetarin e opozitës. Përkundrazi, si pozita dhe opozita, atje ku kandidojnë lideret apo dhe figura të tjera të spikitura të secilës forcë, u krijojnë konstruktivitetin e duhur për t'u zgjedhur. E kundërta mund të ndodh atëherë kur janë të domosdoshme premisa për përmbysje të sistemit politik. Në vendin tonë i kemi të dyja rastet. Në zgjedhjet e para pluraliste në vend, më 31 mars të vitit 1991, Ramiz Alia, numri një i shtetit komunist në vend, “humbi” betejën përsonale elektorale. (!!) Ai e pranoi sfiden se ishte i ndërgjegjshëm se “humbjen” e tij e kërkonte situata politike. Ishte një sinjal se komunizmi e pranoi fundin e tij me një rrugë politike pa shumë gjak. Në zgjedhjet e Korrikut 2005 mazhoranca e atëhershme i vuri kryetarin të opozitës në Kavajë një kundërshtar, (pa dashur ta fyej) honorifik, për t'i krijuar atij terrenin e duhur për të udhëhequr fushatën elektorale të gjithë opozitës. (Fakt është se opozita e para trekorrikut nuk bëri plotësisht të njëjtën gjë me kryetarin e mazhorancës së atëhershme në zonën e Sarandës)

E keqja tjetër lidhet me faktin se qëllimin politik më të lartë, sipas gjykimit të mazhorancës, ajo kërkon ta arrijë me çdo kusht e mjet dhe duket se për këtë ka kohë që punon. Nga ana e vet edhe opozita e ka kuptuar lojën e lëxueshme të mazhorancës. Rezistenca e saj në kërkim të standartëve diktohet më shumë nga përvoja se po ndodhi e keqja askush nuk do të mund ta korrigjojë. Vërrejtjet e ndërkombëtarëve nuk do të kenë vlerë për pasojat e çdo rezultati të manipuluar në jetën e brendshme politike të partive dhe të gjithë vendit. Është pikërisht kjo përvojë që e mban opozitën të bashkuar. Por dhe thelbi i krizës elektorale që mban faktorin ndërkombëtar tepër të kujdesshëm në këmbënguljen e tij për arritjen e standartëve.

Në këtë kuptim defektet ligjore në rregullimin e infrastrukturës zgjedhore, këmbëngulja e opozitës për arritjen e standarteve dhe respektimin praktik të tyre, nuk mund të lidhen thjesht me interesa politike të çastit. As me pamundësinë tonë për të realizuar zgjedhje sipas standarteve evropiane, ose si çdo vend tjetër i parafundit të Ballkanit dhe të Evropës. Lidhen, siç e thamë edhe në fillim, me konceptin e mazhorancës tonë për demokracinë dhe rolin e opozitës në të.

Panajot Barka 07.01.2007

Nga Panajot Barka

Skandale në oborin e PBDNJ-së kompromentojnë keq misionin e politik të lidshimit të tij.

02.02.2009/04.02.2009

Para disa javësh në parlamentin shqiptar plasi skandali i korupsionit qeveritar me fondin për botimin e teksteve shkollore për shkollat e minoritetit etnik grek në gjuhën amtare. Rezultonte që strukturat përgjegjëse të kishin zhdukur në xhepat e tyre mbi 500 milion lekë.

Përpos problemit për korupsion financiar u evidentua qartë një problem i rendë politik. Nuk rendonte aq mbi PD-në si parti kryesore qeverisëse, se sa mbi PBDNJ-shin si parti në koalicionin qeverisëse. Kjo pasi PBDNJ-shi, që mori “ekskluzivitetin” e përfaqësimit politik të Minoritetit Grek në Shqipëri dhe e lidh misionin e vet politik me luftën për garantimin dhe respektimin e të drejtave të njëriut në përgjithësi dhe të minoritetit grek në veçanti, u bë mjeti kryesor për shkeljen e këtyre të drejtave në emër të korupsionit qeveritar. Ky abuzim politik bëhet më skandaloz po të kemi parasysh faktin se bëhet fjalë për të drejtat arsimore të Minoritetit Grek në Shqipëri si e drejta më e pretenduar dhe më e evidente nga ky komunitet.

Atëherë paralajmëruam se skandale të tjera do të plasnin në oborin e kësaj partie. Nuk zgjati shumë dhe para disa ditësh, plasi një skandal edhe më monstruoze. Ai është totalisht i papajtueshëm jo vetëm me misionin politik të deklaruar të kësaj partie, por as me parimet me elementare të një shoqërie minimalisht të civilizuar. Po ashtu përmasat antihumane të këtij skandali janë totalisht të papajtueshme me çdo lloj penalizimi nga ana e drejtësisë të përfaqësuesve përgjegjës të kësaj partie.

Fjala është për skandalin në Qendren Kombëtare të Femijve të Ngjuar në Poliçan. A ka dramë njëzore më të madhe se ajo e atyre 22 femijëve të grumbulluar në atë Qendër? Sigurisht që jo. Por përfaqësuesit e kësaj partie që drejtojnë Ministrinë e Punës, të Çështjeve Sociale dhe të Shansëve të Barabarta, si ministri përgjegjës për menaxhimin e kësaj Qendre, dhe drejtuesit e pushtetit lokal në Poliçan, po ashtu, përfaqësues të kësaj partie, përgjegjës për administrimin e saj, dramën e tyre e kthyen në më shumë se tragjedi. Shpresa e këtyre femijëve për të shijuar jetën në liri larg ngujimit, për të pasur pak me shumë bukë, për të pasur lodra, libra, shokë, shpresa për të shijuar femijërinë edhe pse larg prindërve, shpresa e këtyre femijëve, që nuk guxojnë as fytyrën për të ekspozuar në ekran, për shkak se mund të bëhen objekt i gjakësit të familjeve të tyre, u vra. U vra nga korupsionistët e kësaj partie. Këta femijë, u rikthyen në kullat e ngujimit më të urritur, më të braktisur dhe shpresëvrarë. Jeta për ta tani më u identifikua me qëllimin për të vlarë gjakësin. Por në shtjekëzën e pushkës së tyre do të shfaqet vazhdimisht një gjakës tjetër. Shoqëria dhe shteti që i përjashtuan përfundimisht nga radhet e tyre. Dhe ata rrjedhimisht do të kenë vetëm një kënaqësi, - hakmarrjen vrasëse.

Do të mjaftonte aq që drejtuesit e kësaj partie të mirrinin një vendim për ta shkrirë atë. Do të mjaftonte aq që ligji i lustracionit për krimet e komunizmit të çvlerësohej.

Por ende pa u mbyllur ky skandal, (në fakt akoma s’u hap), plasi një skandal tjetër. Raporti i Bankës Botërore për projektin turistik të Jugut dhe bllokimi i tij, na nxorri lakuriq misionin e Bollanos në krye të Bashkisë së Himarës. Zbuloi thelbin e “nacionalizmit grek” dhe vertetësinë e “antishqiptarizmit” të tij. Mjafton të qendrojmë tek fakti i Jalës, perlës turistike në mrekullinë e Bregdetit. Në fillimverën e 2007ës, në Jalë u prishen 13 objekte private, shumica e të cilave me leje dhe të ndërhuara mbi troje

private larg vijës së ndaluar të bregut të detit. U prishen në emer të masterplanit turistik të Bankës Botërore. Në fakt që të ndërtohej një objekt tjetër, që sipas deklaratave në parlament, i takon një të afërmi të kryeministrit dhe s' ka asnjë lidhje me projektin e kësaj Banke. Në atë kohë, zëri i Bollanos në mbrojtje të interesave të ligjshme të Himariotëve në Jalë, disa prej të cileve me kombësi të deklaruar greke, u bë tëpër i hollë deri në mekje. Mirëpo po, në këtë periudhë grabitjesh të trojeve turistike në Bregdet, zëri i Bollanos u bë i trashë, duke artikuluar “parulla antishqiptare”. Opinioni medjatikë dhe ai publik në vend u muarr për një kohë të gjatë me këto bollanisma. Kjo gjë krijoi hapësirën dhe qetësinë e duhur që qeveritarë, politikanë, mafiozë dhe të afërm të tyre, të rrembënin fileton turistik të bregdetit. Pasi ky proces eci suksesshëm, Bollano shpalli mik të Himarës Berishën, ndërkohë që shteti i të cilit bën sikur i hap gjyqe dhe e ndjek penalisht “antishqiptarin” Bollano.

Formula e përdorur synonte më shumë neutralizimin e reagimeve të mundshme të Greqisë interesat e së cilës presupozohet në Tiranë se janë shumëplanëshe. Sznonte gjithashtu mundësinë për mbijetësë politike të klanit të Dule-Bollanos, pasi tanimë janë specializuar dhe provuar si të aftë për këto “marifete të thjeshta”

E vertetë është se në Athinë është artikuluar dhe po krijohet bindja se parullat “antisghqiptare” të Bollanos porositen nga vet Tirana. Megjithatë, shteti “amë” i Bollanos edhe pse nuk u muarr hapur me mbrojtjen e tij nga “nacionalizmi shqiptar” i cili, “duke sulmuar” Bollanon, kërkon të mohojë përkatësinë “etnike greke të Himarës”, nuk e braktisi atë. Ky qëndrim vjen nga presioni i një opinioni, përpunuesit e të cilit në Athinë janë disa himarjotë. Ata, janë parë në Himarë, ta zemë në raste zgjedhjesh, kanë hedhur nga ndonjë shashkë nacionaliste greke dhe janë kthyer në Greqi. Ndërkohë strukturat kopetente të shtetit shqiptar i shpallin në kërkim pasi janë siguruar se e kanë kaluar kufirin shendoshë e mirë. Njëkohësisht japin sinjalin që të ndizen të gjitha motoret antigreke.

Po e mbyllim këtë shkrim duke perseritur të njëjtën deklaratë. Skandale të tjera edhe me të rënda e presin oborrin e PBDNJ-së. Askush të mos kujtojë se këto skandale lidhen me ligjin e lustracionit, zbatimi i të cilit mund të ngërthejë kupolen politike të kësaj partie.

Skandali politik i radhës lidhet me vendimin e pritshëm të Dulës për t'u larguar nga koalicioni i Berishës për të kaluar me atë të Ramës. Vonesa në shpalljen e një vendimi të tillë nuk lidhet me nevojën e thirrjes së kongresit për të marrë vendimin organi kolegjal. (Thirrja e Kongresit të PBDNJ-së aty nga marsi është një truk i Dulës për të shkarkuar përgjegjësinë e turpit nga vetja). Vonesa e thirrjes së Kongresit lidhet me kohën që u duhet disa segmenteve me etiketën e interesave greke (që kanë përfitime të majme se operojnë në emrin e minoritetit etnik grek në Shqipëri), për t'u bindur plotësisht se kush do t'i fitojë zgjedhjet. Nga kjo varret edhe qëndrimi i “kongresit” të Dulës. “Partinë përfaqësuese të minoritetit” segmentet e sipërpermendura e duan në qeveri se kështu i kanë krahët me të sigurta. Por kjo i intereson edhe Dulës, pasi pa qenë në qeveri, “partia e tij” bëhet shkumb e hi.

02.02.2009. Δημοσίευτηκε στη GAZETA Shqiptare και Tema στις 04.02.2009

Nga Panajot Barka

Zgjedhjet e 28 Qershorit pasqyrë e realitetit politiko-shoqëror të vendit

21.07.2009

a. Mesazhet e Perendimit dhe realiteti politik shqiptar.

Mesazhet e fundit të përfaqësuesve të BE-së dhe SHBA-së në Shqipëri drejtuar Kolegjit Zgjedhor, treguan edhe një herë vendosmerinë e Perendimit për rendësinë e zgjedhjeve të 28 Qershorit. Vertetojnë se ato përshkohen nga deformime që duhen rregulluar dhe se procesi duhet përfunduar sa më shpejt që të përvijohet në vend një qeveri legjitime. Këto “direktaiva” duhen zbatuar konkretisht nese është e vertetë aspirata e deklaruar e politikës shqiptare për t’u bërë pjesë e Evropës. Faktori ndërkombëtar, tregon gjithashtu se në kërkesat e tij kërkon edhe aleatë të brendshëm, siç janë institucionet legjitime dhe votuesi shqiptar.

Realiteti politik shqiptar tregon tjetër gjë. Vendin kryesor e zë aplikimi i teorisë së faktit të kryer dhe spostimi i vemendjes nga testi bazë dhe elementar i Demokracisë që janë zgjedhjet, te ngjarje të dorës së dytë. Nuk bëhet fjalë për rastësi. Janë veprime të mirëprovuara të atij grupi njërëzish që kontrollojnë paketën e jetës politike në vend në periudhën e tranzicionit. Hapësira që shfrytëzohet në mënyrë abuzive ose hipokrite fillon tek performanca civile e shoqërisë tonë dhe mbaron tek marrëdhëniet me faktorin ndërkombëtar. Qëllimi po aq i qartë, ruajtja e paprekur e integritetit të këtij grupimi në raport me jetën politike në vend.

Teoria e faktit të kryer u vu re tek nxitimi për të shpallur koalicionin e ri qeverisës. (Këtij akti i parapriu mobilizimi i të gjitha mjetëve, sidomos i medias për “të argumentuar” pse është i pamundur bashkëpunimi i LSI-së me Ramën dhe pse ishte e mundur shartesa me Berishën). Së dyti me funksionimin e qeverisë elektorale dhe post elektorale si një qeveri që ka marrë mandatin parlamentar. Së treti, me “nxjerrjen” e dhëmbëve në bazë ndaj kundërshtarëve humbës.

Ndërsa si ngjarje të dyta drejt të cilave po spostohet vemendja politike po përmendim përjashtimim nga e drejta për të lëvizur pa viza në Evropë, duhet apo nuk duhet të japë dorëheqjen Rama etj. Siç e thamë nuk bëhet fjalë për rastësi.

b. Zgjedhjet, lehtësimi i vizave dhe performanca civile e shoqërisë tonë

E para, vendimi i BE-së për të na lenë pas Serbisë në çeshtjen e lehtësimit të vizave përfshin brenda vetës aspiratën pragmatiste të shqiptarit të thjeshtë për integrimin e vendit në BE. Perendimi, i afërt ose i largët, në të gjitha nivelet e artikuloi qart. Rasti për liberalizimin e vizave u humb se në zgjedhjet edhe kësaj radhe u shkelen standartet. Dhe logjika vazhdon po me kaq thjeshtësi. Është e vertetë se votuesi i thjeshtë shqiptar e kreu misionin e vet. Votoi pa “eksese”. Por misioni i tij për Perendimin nuk mbaron këtu, pasi votuesi shqiptar lëjon administratorin e votës së tij t’i ndryshojë verdiktin. Është kjo arsyeja që kryeministri i zgjedhjeve Sali Berisha nxitoi të shkepus këtë vendim të BE-së, i cili cenon edhe shpresat apo interesat e votuesve dhe pasuesve të tij më të zjarrtë, nga standarti i zgjedhjeve.

Por, BE-ja bashkë me shuplakën që i jep politikës, i kumton edhe shoqërisë shqiptare se i duhen ato institucione dhe ajo infrastrukturë që të pengojë politikën të manipulojë deri edhe rezultatin e zgjedhjeve. Pra, Perendimi kërkon tek shoqëria shqiptare, aleatin e brendshëm për fatin e zgjedhjeve të tij (!!!)

Megjithatë, kjo, sado e rëndësishme që të jetë (dhe është jashtëzakonisht shumë), është me më pak rreziqe se sa përpjekja e kësaj pakete kontrolluese të jetë politike në vend për të eliminuar faktorin tjetër politik (në rolin e opozitës ose jo, në rastin tonë të PS-

së) dhe determinizimin e pluralizmit shqiptar nga interesat e ca pokërzhinjve politikë. Aq më keq pasi kodi i ri elektoral provokoi një sistem politik bipartiak në vend duke provuar atë që dihej se shumë parti të vogla politike ishin fiktive.

c. Dorëheqja e kërkuar e Ramës dhe institucionet e pluralizmit shqiptar

E gjithë kjo lidhet me faktorin e dytë, me dorëheqjen e Ramës. Sipas analizës tonë, nuk është fjala për dorëheqjen e një politikani, por për një institucion me rendësi, nga i cili varen pasojat që do të riciklojnë krizën e tranzicionit për një kohë edhe më të gjatë se ajo që shkoi.

Ç' do të thotë kërkesa për dorëheqjen e Ramës ? Pse kjo kërkesë vjen më së shumti dhe më me intensitet nga faktorë jashtë PS-së? Pse kjo kërkesë ekclipsoi totalisht kërkesën për qartësi dhe transparencë të procesit zgjedhor? Përse, sipas perendimorëve, politika abuzon me pushtetin e vet për të penguar këtë transparencë? Përse kjo kërkesë nxiton dhe nuk pret të dalë rezultati përfundimtar i zgjedhjeve? Përse....???

Realizimi i kësaj kërkesë do të thotë: Institucionalizimin e rezultatit të dëshiruar dhe jo faktik zgjedhor. Detyrimin e faktorit ndërkombëtar të “vë re” parregullsi në standarte demokratike por t'i pranojë zgjedhjet. Për më shumë do të thotë riinstitucionalizimin, si të pazëvendësueshëm, të apo atyre faktorëve që përgjatë këtyre 20 vjetëve bënin sikur ziheshin në publik dhe për interesat e tyre të vogla mirreshin vesh në prapaskenë dhe në çdo rast e shpërbënin këtë vend, madje edhe kur ia kishin njëri- tjetrit me të ngesur. Pas dorëheqjes së Ramës, llogaritet që PS të mirret totalisht me veten. Kështu do të hynte në ciklin e shpërbërjes së vet të mëtejshëm, (të nisur nga Meta). Forca politike e PS-së në parlament do të reflektonte interesat dhe rymat të pushtetshme jashtë partisë, apo frymën e varësisë dhe “të meritës” politike nga persona konkretë. Pra, do të kemi eliminim të opozitës reale dhe një pakufi pushteti prej qeverisë së re, heqjen e mundësisë së PS-së për të marrë pushtetin edhe në të ardhmëm, kontrollin e PS-së nga e njëjta paketë kontrolluese e politikës në vend.

Në Shqipëri, janë të tepërtat analizat për këto fenomene. Kjo pasi si historia e largët partiake në vend, para monizmit dhe gjatë tij ashtu edhe ajo pluraliste post komuniste, është tepër pasur me eliminime politike dhe e dhimbshme për nga mënyra e realizimit. Këtë përvojë e përjetoj edhe PD-ja në periudhën 1996-1999. Mbijetoj se lideri i saj S. Berisha, me të mirat dhe të këqijat e veta, jo vetëm që e shpetoi atë nga shpërbërja, por shumë shpejt e ktheu serish në pushtet.

d. Berisha, Meta, Nano dhe dorëheqja e Ramës

Nga ana tjetër secili nga ata që mund t'i quajmë tani për tani eksponentet e paketës kontrolluese të jetës politike në vend kanë arsyet e tyre personale për të kërkuar dhe dëshiruar dorëheqjen e Ramës.

Dihen arsyet përse e kërkon Berisha. Do të mund të formojë qeveri, do të qeverisë me duar të lira dhe këmbë të forta. Do të sigurojë qeverisjen edhe për një mandat tjetër, kësaj here pa Metën. (të cilën, nese Rama jep dorëheqjen mund ta detyrojë të largohet nga koalicioni. Mund të mos i duhet më se ka shokët e Nanos të mbetur në PS)

E do pa tjetër edhe Meta. Ai e di dhe praktika e ka provuar zvogëlimin deri në zhdukje të partive të vogla në koalicione të tilla qeverisese, aq me keq me ngjitje të sforcuar e që pa filluar shkaktoi reagime të ashpra dhe përçarje në gjirin e vet dhe në të gjitha nivelet. Meta është i ndërgjegjshëm se perspektiva është akoma më e zymtë me një PS të fortë.

Pavarësisht se pa kujtesë votuesi i majtë shqiptar nuk harron se më 2005 ai ishte faktori determinant i dukshëm që i dha pushtetin Berishës. E rikuperoi imazhin politik me 2007. Bashkëpunimi me PS-në i dha të majtës fitorën në zgjedhje lokale. Por pa kaluar shumë kohë Meta e kaloi forcën e vet politike në pushtetin vendor në shërbim të PD-së. Tani i mashtroni serish. Por votuesi është si Perendia që fal kur duhet dhe mund të

vonojë por nuk harron (kur të denon). Dhe PS-ja me Ramën nuk mund të bëhet porti i strehimit të tij nga stuhitë e pritshme.

E do dhe Nanua. Vertet që ka shumë arsye politike personale të kërkojë tatëpjetën e Ramës. Por kërkesa e tij shikohet edhe si një shërbim i ri ndaj Berishës për ta bërë atë President. Nga ky pozicion të kontrollojë pastaj edhe PS-në. (Në Shqipëri ky model presidenti ka treguar se është personalisht më efektiv se modeli Moisiu apo i Topit). Pastaj Nanua e njeh mirë Berishën. Në të gjitha marrëveshjet politike që benë midis tyre që nga viti 1992 (dhe nuk janë pak) rallë ka përfituar prej tyre Nanua. Kështu që kjo kërkesë, veç arsyeve të përbashkëta, është një kusht, qoftë edhe i pathënë, për ambicjet e Nanos.

e. Kryetari i PS-së E.Rama në raport me pluralizmin shqiptar.

Në aspektin e politikës globale dhe pluraliste në vend pozicioni dhe roli institucional i Ramës si kryetar i Partisë më të madhe në vend, në këto momente është i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm. Ai nuk mund të gjykohet tani për gabimet. Atij duhet t'i jipet mbështetja e duhur për të ruajtur baraspeshën e pluralizmit në vend. Në aspektin politik personal, pozicioni i tij është dramatik. Duhet të mbajë personalisht mbi vete betejën për të vertetën e zgjedhjeve. (Duket se edhe bashkëpunëtorë të tij në çeshtje taktike zgjedhore, po e lenë, ose se duan të shpetojnë kokën, ose shpresojnë se PS-së do t'i vijë një kokë e re). Atij po i ngarkojnë peshën e humbjës, (jo pa qellim dhe pa dashakeqje). Brenda partisë delfinët me nxitim të komanduar nga faktorë ekstra partiakë, hapen kacakët e pasionëve të fshehura për të marrë frenat e PS-së. (Ndoshta kështu mund të shpjegohet dhe gëzimi i heshtur i tyre për humbjen e mundshme të Ramës në zgjedhje, apo dhe rezultatet e tyre zgjedhore të ulta). Ka për të përballuar, faktorë të stërkonsumuar dhe të dalë mode në PS, të mënjanuar prej tij, ose të vetpërrjashtuar, të cilët shpresojnë se u erdhi serish ora. Ka për të përballuar, aleatët e koalicionit që humbjen e tyre duan t'ja faturojnë Ramës. Ka për të përballuar koalicionin qeverisës si pjesë e dukshme e paketës kontrolluese të politikës shqiptare dhe pjesën e skemës së tyre që nuk duket akoma por, po ndihet e përvijuar qartë dhe duket se mos dorëheqja e Ramës (kur pritej e shpejt) po e zbulon, e pengon dhe e prish atë. Ka për të përballuar zhgënjimin dhjetra mijra votuesve që e besuan atë me shpresën e ndryshimit dhe tani do të vuajnë edhe ekspozimin e peshës së tyre.

f. Dorëheqja e Ramës e palejueshme edhe sikur vet ta kërkonte.

Në këto rrethana, i mirë apo i keq, Ramës nuk i lëjohet dorëheqja. Nuk është e justifikueshme as në planin individual. (Në këtë aspekt dorëheqja për të do të ishte shumë komode). Dorëheqja vertet është një çeshtje e moralit të brendshëm të çdo faktori. Por gjithmonë në raport të drejtë me mënyrën e funksionimit të jetës politike në vend. Nuk mundet që kur gjithë rruga është me gropa, të fajësohet makina që s'ecen. Kjo ka vlerë edhe në rastet kur shprehet në mënyrë taksative rregullatori statutor i një forumi apo partie. Dihet vertet se në PS është i njohur institucioni i dorëheqjes, i "aplikuar me sukses" nga Nano. Po, por Nanua jipte dorëheqjen ose si një mundësi shlyerjeje të fajit për t'u rikthyer dhe për të bërë të njëjtin faj por me mënyra të tjera (rasti i shtatorit 1998) ose për të arritur personalisht një ambicje tjetër politike (Rasti i 2005-s që i dha mundësi Berishës për të marrë pushtetin në këmbim të postit të presidentit).

Nga ana tjetër një analizë më e gjerë dhe më gjakftohte na thotë se pavarësisht nga humbja e PS-së, (ende e pa vertetuar) e cila i faturohet Ramës për shkak të evidentimit të individualitetit të vet në zgjedhje, në këtë proces ai ka merita dhe vlera të cilat PS-ja i kishte të domosdoshme.

Së pari. Rama e nxorri PS-në nga makthi i ndërjegjës së vet politike se ajo nuk mund ta marrë pushtetin (veçanërisht kur e ka Berisha), pa ia dhenë të tjerët, por mund ta

dorëzojë edhe kur ia vjedhin edhe kur ia shesin për interesat të karrierës private. (PD-ja, përjashto 1992-shin, i humbi të gjitha zgjedhjet dhe e mbajti pushtetin me shumë se e majta, që i fitoi realisht ato)

Së dyti. Ai ndërmori një fushatë në të cilën u mëshoi idealeve. Nuk e di sa të qartë e kishte se kundërshtarë në këtë betejë do të kishte jo vetëm pushtetin e Berishës, por edhe mentalitetin e intersaxhinjve të politikës meskine dhe të ryshfexhinjve banalë që shesin interesat e forcës politike që përfaqësojnë për 100 Evro.

Së treti. Kjo ishte situata që garantonte një jumbje shumë të thellë. Flasin për këto dy fakte. Berisha, përdori për fitorën e tij të njëjtën taktikë si më 2005, por më të sofistikuar. P.sh. PD-ja, si më 2005, ashtu edhe në 2007 (zgjedhje lokale) “korri” fitore në fshat dhe humbi në qytete. Që do të thotë se fshatari shqiptar është i djathtë (!!) dhe qytetari shqiptar i majtë (!). Realisht duhet lexuar se fshati ishte me pak i kontrolluar ndaj manipulimeve dhe se fshatari (praktik nga natyra) pranoi ato pesë para në dorë, (sa ishte çmimi i caktuar i votës së tij) se sa premtimin e Ramës për vezë të arta.

Po ashtu, në këto zgjedhje pati një rritje të pjesëmarrjes në votim në masën 8-10 %. Logjika elektorale kërkon që këto vota të shkojnë për opozitën dhe jo për qeverinë e cila sido që të jetë ka një konsum politik që sjell reagimin e kundërt, pra të mos pjesëmarrjes. Në këto zgjedhje ndodhi e kundërta. (!?)

g. Një konkluzion

Ajo që duhet të bej tani PS-ja është të mbrojë të vertetën e zgjedhjeve, të mbrojë zgjedhësit e vet nga abuzimi partiak i pushtetit qeverisës, të bejë analizat e zgjedhjeve, të ngrejë strukturat partiake si një gërshtetim të jetës tradicionale të PS-së me frymën e re perednimore dhe të synojë marrjen e pushtetit. Ndryshe do të jetë një opozitë rakitike me apo pa Ramën.

P. Barka për gaz “shqiptare”. 21.07.2009

Nga Panajot Barka

<https://www.pressreader.com/>

<https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20150830>

<https://balkanweb.com/te-pathenat-e-kishes-se-dhermiut/>

Polifonia, si produkt multikulturor shekullor është e Epirit

Intervistë tek Gazeta shqiptare për deklaratën time në lidhje me polifoninë.

30.08.2015

PROF.Barka “GSH”-Në portale qarkullon një deklaratë e juaja sa i takon isopolifonisë, që ajo të hiqet nga UNESCO. Është e vërtetë që ajo është deklarata juaj?

Nuk e kuptoj saktësisht perse bëhet fjalë dhe kujt i referoheni. Nese e keni parasysh një ndërhyrje timen në një simpozium lokal në Ktismata të Greqisë, një nga vatrat më të gjalla të polifonisë së Epirit, atëherë ndjem i fyer. Në atë ndërhyrjen time unë parashtrova tezat e njohura të miat për polifoninë. Unë e konsideroj këngën politfonike si emblemën e gjallë të Epirit, si një element të karakterit diakronik multikulturor të Epirit. Për mua nuk ka rëndësi se në çfarë gjuhe këndohet. Si e tillë ajo nuk pyet për kufij gjuhë paragjykim. Madje theksova se një tregues për këtë është edhe fakti se në pjesën jugore të Epirit vitet e fundit ka një pelqim të polifonisë të shoqëruar me saze të ardhur nga zona e Permetit dhe Ersekës ndaj çdo paragjykim është diskriminim ndaj polifonisë ashtu siç është diskriminim çdo përpjekje për ta quajtur atë pronë e dikujt dhe në një territor të ngushtë. Pra unë folam me gjuhën e multikulturës që është fryma më evropiane dhe e klasifikova këngën politfonike si etalonin e multikulturës në të cilën priret sot kultura evropiane dhe botërore dhe se Epiri e zotëronte këtë vlerë që nga lashtësia. Në këtë kuadër thashë se fatkeqësisht, kjo është konsideruar vetëm si këngë shqiptare, dhe jo si këngë e Epirit në përgjithësi. Unë nuk besoj se ka diçka të keqe në këtë mes, sepse kjo është një e vërtetë. Unë kam diskutuar me Vaso Tolen kur i kam përklthyer librin në greqisht në lidhje me polifoninë. I kam bërë të njëjtat vërrejtje në këtë përkthim. Pra, e konsideroj të gabuar dhe në shërbim të nacionalizmit qëndrimin e kundërt, madje të gabuar kur kënga politfonike konsiderohet si këngë jo e Epirit si krahinë unike me një trashgimi që vjen që nga koha tjetër e antikitetit, që nga koha e Dodonës kur nga kjo polifoni e Epirit lindi muzhika e Pitagorës dhe harmonia greke në përgjithësi ku u mbështet në vijim gjithë arti muzikor botëror. Këtë qëndrim mbaj në studimet e mia për këngën politfonike. Unitet dialektik multikulturor në një diakroni tjetër kufijve historike dhe mitologjike. Them që sot në Epir këndohet në tri gjuhë, ashtu siç e provoj që ka një hartë shtrirje pothuaj sa perandoria e Aleksandrit të Madh. Them edhe që është gabim nëqoftëse do ta konsiderojmë këngën politfonike si këngë shqiptare, si këngë greke. Është element i multikulturës që është karakteristikë e Epirit.

“GSH”: Pra ju nuk keni thenë në atë takim që të hiqet Isopolifonia nga UNESCO?

Kjo është marrëzi. Unë thashë që isopolifonia, të jetë në UNESCO por të jetë me të gjitha tiparet karakteristike të saj, të cilat i përshkrova më sipër. Ka një dallim shumë të madh njëra me tjetrën. Me këtë temë dhe me këtë qëndrim unë kam bërë referime në Kosovë, në Shkup, kam shkruar artikuj në shumtë në revista ndërkombëtare- se e konsideroj si vlerë të qenësishme multikulturore. Atë që kërkon bota sot në e kishim shëkuq përpara.

-“GSH”-Në kushtet që dihet debati që ngjallet në Shqipëri ose mënyra se si njihet në Shqipëri ajo që quhet zonë e Epirit dhe pretendimet greke, a ka vend për keqkuptim nga deklaratat tuaja?

Këto janë qëndrime të atyre që nuk kanë miell të shtisin dhe mitrren me krundet. Nuk ka pretendime të tilla që të përfaqësojnë politikën serioze greke. Ato janë në kokat e atyre

që duan të mbijetojnë politikisht, strehë e tejkaluar. Nëse ka element të tillë në Greqi ata janë shumë më të pakët se ata në Shqipëri që pretendojnë se kufiri i Shqipërisë është deri në Peloponez. Këto nuk janë gjëra që i atribuohen një profesori, ose një autoriteti shkencor. Këto janë gjëra me të cilët merren njerëz të cilët nuk kanë as nivel, as kulture, por që përpiqen të mbijetojnë më gjënë më të thjeshtë, që është nacionalizmi. Argumenti shkencor kërkon argument shkencor dhe jo abuzime nacionaliste.

Faleminderit